

EPPC Albania kërkon një **Menaxher Shitjesh** për klientin e saj, i cili është një nga shpërndarësit më të mëdhenj të materialeve të ndërtimit në vend.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Monitoron tregun, nevojat e klientëve dhe ofertat e konkurrentëve;
- Kryen aktivitete shitjeje;
- Bën propozime për modifikimin e politikave të çmimeve dhe politikave të biznesit nëse është e nevojshme për të arritur qëllimet strategjike;
- Bashkëpunon në projektet e Marketingut të kompanisë (panaire, promovime, etj.);
- Planifikon, përgatit dhe realizon evente promovuese;
- Vlerëson tregun dhe raporton në lidhje me zhvillimet dhe ndryshimet e tij;
- Raporton në mënyrë periodike tek menaxheri i përgjithshëm.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- **Të ketë arsim të lartë;**
- Përvojë të mëparshme pune në shitje (përbën avantazh në këtë industri);
- Aftësi të mira negociuese, komunikuese dhe ndërpersonale;
- **Të posedojë leje drejtimi dhe të ketë disponibilitet për të udhëtuar;**
- Njohja e gjuhës Angleze përbën avantazh;
- Të jetë miqësor dhe energjik me fokus shërbimin ndaj klientit.

Të dhënat:

Pozicioni:	Menaxher Shitjesh;
Vendndodhja:	Tiranë;
Raporton tek:	Menaxheri i Përgjithshëm;
Pagesa:	Shumë e mirë (<i>fikse + bonuse+makinë</i>);
Kontrata:	Sipas Kodit të Punës;
Aplikimet mbyllen:	10.05.2019

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke ndjekur linkun e mëposhtëm:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj do të kualifikohet. Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.